Kronikë

# VIDEO/ Kontrolle në Vlorë, shpallet në kërkim anëtari i një grupi kriminal! Në shtëpi i gjetën pistoletë dhe 39 mijë euro

*Një pistoletë dhe 39 mijë euro janë sekuestruar në banesën e Rodrigo Shemshos, anëtar i një grupi kriminal që është shpallur në kërkim nga policia e Vlorës.*




Redaksia
1 Prill, 12:56 | **Përditesimi: 1 Prill, 18:33**

**VLORË** - Një pistoletë gati për qitje dhe 39 mijë euro janë sekuestruar në banesën e Rodrigo Shemshos, anëtar i një grupi kriminal që është shpallur në kërkim. Kjo u zbulua pas kontrolleve të FNSH në ambiente të ndryshme, të dyshuara të përdorura nga pjesëtarë të grupeve të ndryshme kriminale.

Arma e zjarrit dhe shumë e parave që u sekuestruan në banesën e Shemshos në lagjen 'Pavarësia' pasi dyshohet se janë përfituar nga veprimtaria e grupit kriminal.



LEXO EDHE:
**Moti i keq/ Pezullohet lundrimi i mjeteve të vogla dhe anijeve të peshkimit në Vlorë dhe Durrës**

Rodrigo Shemsho, 33 vjec akuzohet për veprat penale "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe municionit", "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale" dhe "Fshehja e të ardhurave". Vijon puna për lokalizimin dhe kapjen e tij.

Kontrollet intensive do të vijojnë në të gjithë qarkun, me qëllim parandalimin dhe goditjen e veprimtarive kriminale. Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë, për veprime të mëtejshme.

A.M./M.Q./Shqiptarja.com

TAG: Vlore fnsh rodrigo shemsho

Komento

## Komente

**Hasan comangia:** 01/04/2023 17:09
Jan grupi Nar Mustes keta.Jan hall i madh mos te renshin ne pjes
Përgjigju

**Lagja:** 01/04/2023 18:16
Dava lepujsh

**Landi:** 01/04/2023 14:24
Mire beni qe veni kontroll po ata te grupit aty ne lagje i keni te gjithe dhe shume te tjere ne krahun perball keni shume o polici kriminale ju i dini te gjitha pse si kapni keni prova te cdo vrasje apo plagosje apo shandazhe qe u jane bere bisezmenve per para nga keta maskarenj turp tu vi qe i lini e livadhisin neper vlore
Përgjigju

**Tani topit:** 01/04/2023 14:55
Te kujt grupi jan kta

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

**Sondazhi i ditës:**
**Lidhjet ruse të Monika Kryemadhit, a duhet që drejtësia të nisë hetimet?**

Po | Jo | Nuk e di

## Lajme të tjera


Arrestohet 18-vjeçari në Vlorë, ishte në kërkim prej 3 muajsh si autor i dyshuar i 8 vjedhjeve
1 Prill, 10:04


PS ankimim në KAS, kërkon mosregjistrimin në zgjedhje të kandidatit të pavarur në Sarandë, Gjergj Mërkuri: Ka falsifikuar firmat
31 Mars, 19:51


Këngëtari i mirënjohur italian Pupo rikthehet me një koncert në Vlorë: Pashë emocionin e publikut vlonjat, ndihem i lumtur
Armand Xhelili
31 Mars, 16:01


Konflikt në familje/ Shpallen në kërkim dy vëllezër në Vlorë, goditën me makinë bashkëshortin e motrës së tyre
31 Mars, 11:43


VIDEO/ Shembet muri mbrojtës krah rrugës kryesore te Uji i Ftohtë, bllokohet rruga nga gurët! Kalohet vetëm në një korsi
31 Mars, 08:40


Probleme me deklarimin e pasurisë, KPA lë në fuqi vendimin e KPK për shkarkimin e gjyqtarit të Apelit të Vlorës, Hysen Saliko
30 Mars, 22:06


Aksident në Vlorë, përplasen dy makina! Dy të plagosur, ambulanca niset drejt vendngjarjes
30 Mars, 17:22


Kishte ngecur me velierë në grykëderdhjen e Vjosës disa ditë më parë, turisti gjerman detyrohet të 'braktis' mjetin në cekëtinë
30 Mars, 13:10


Kandidon i pavarur për kreun e bashkisë Sarandë, Gjergj Mërkuri akuzon PS: Po u bën presion qytetarëve të tërheqin firmat për kandidimin tim
29 Mars, 22:13


Përçahen demokratët e Berishës në Sarandë, kryesia kundër Rithemelimit për renditjen e këshilltarëve bashkiakë: U caktuan nga Tirana, vendosën më lart emrat e Metës
28 Mars, 22:17


'14 maji'/ Kandidati Ermal Dredha prezantohet me strukturat e PS në Vlorë: Do të jem pranë qytetarëve të thjeshtë në qytet e në fshat
Armand Xhelili
28 Mars, 18:10


26 vite nga tragjedia e Otrantos, familjarët e viktimave jetojnë me dhimbje: Nuk na thanë që po iknin! 23 viktima pa varr
Armand Xhelili
28 Mars, 11:52



© 2011 - 2023 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje